


Kronikë

# E rëndë në Shkodër, xhaxhai po pastronte çiften, qëllon aksidentalisht nipin! Ndërron jetë 10 vjeçari

*Një ngjarje e rëndë me pasojë vdekjen e një fëmije 10 vjeç ka ndodhur mbrëmjen e të martës në fshatin Samrisht të Shkodrës. I mituri është qëlluar aksidentalisht me çifte nga xhaxhai i tij, i cili ishte duke pastruar armën kur u shkreh aksidentalisht.*

Redaksia
9 Gusht, 22:16 | **Përditesimi i fundit: 9 Gusht, 23:00**

Një ngjarje e rëndë me pasojë vdekjen e një fëmije 10 vjeç ka ndodhur mbrëmjen e të martës në fshatin Samrisht të Shkodrës. I mituri është qëlluar aksidentalisht me çifte nga xhaxhai i tij. Për pasojë ka marrë plagë të rënda dhe ndonëse ambulanca ka mbërritur me urgjencë në vendin e ngjarjes për t'i dhënë ndihmën e parë, i mituri i identifikuar si B.J., ka ndërruar jetë.

Burime për Report Tv bëjnë me dije se xhaxhai i identifikuar si Vlash Jakaj, 68 vjeç ishte duke pastruar armën dhe është shkrehur. Arma e gjahut 'çifte' që i mori jetën të miturit ishte me leje në ngarkim të xhaxhait. Nga e shtëna aksidentale është plagosur në dorë dhe vetë xhaxhai, i cili është jashtë rrezikut për jetën.



LEXO EDHE:
**Rama: Gati të nënshkruajmë protokollin e bashkëpunimit me El Alabbar, i hap rrugë fillimit të investimit në Portin Turistik të Durrësit**

Në vendngjarje ndodhet grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, për kryerjen e veprimeve dhe zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

A.M./Shqiptarja.com

TAG: Shkoder | vlash jakaj | çifte | arme gjahu | samrisht

Komento

## Komente

**B*3:** 10/08/2022 15:38

Ajo qe e karakterizon me shume burrin shqiptar, eshte PAPERGJEGJSHMERIA. Papergjegjshmeria ka sjelle shume te keqija (per mos cituar asnje). Papergjegjshmeria vjen si pasoje e PANDESHKUESHMERISE. Rrofte drejtesia shqiptare. Populli, nqs do vehten dhe jeten, duhet te ngrihet te protestoj kunder sistemit te kalbur te drejtesise, jo te ngrihet per interesat e Sales, Metes... Ngushellimet me te sinqerta familjareve! Zoti e paste engjellin e vogel ne Parajse!

Përgjigju

**Lepuri:** 10/08/2022 09:37

Pastron çiften e mbushur ne prani te femijeve. Po kjo a nuk eshte vrasje me dashje?

Përgjigju

**BENI:** 10/08/2022 00:07

MOS PASTRO ARMEN KUR KE FEMIJE NE SHTEPI,,,NUK PRISJE DOT O ZOG GOMARI TA PASTROJE NESER.....

Përgjigju

**Edmond:** 09/08/2022 22:51

Ngushellime Nje arme e dorzuar vullnetarisht , ose nje arme e bllokuar Nje Jet e shpetuar Nqs ka monatorjum pse duhet te jen armet me leje .

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**A po menaxhohet si duhet situata me zjarret në vend?**

PO | JO | NUK E DI

## Lajme të tjera

Kronikë

Zjarr i përmasave të mëdha në Lenie të Gramshit
10 Gusht, 20:25

Ekonomi

Ndërtimi i portit turistik të Durrësit, investitori Muhammed El Alabbar: Premtoj se do të marrim mendjet më të mira për krijimin e një jete të re
10 Gusht, 20:24

Ekonomi

Balluku jep detaje nga baza e NATO-s në Porto Romano, që u prezantua Bruksel
10 Gusht, 20:20

Ekonomi

Rama krah El Alabbar: Mbyllëm negociatat! Do nënshkruajmë protokollin e bashkëpunimit, i hap rrugë fillimit të investimit në Portin Turistik të Durrësit
10 Gusht, 20:14

Opinion

Skënder Minxhozi: Kur Meta e Berisha refuzojnë të shihen në pasqyrë
Skënder Minxhozi
10 Gusht, 20:07

Politikë

Meta-Ramës: Unë jam Ilir Rexhep Metaj, se kam ndryshuar asnjëherë
10 Gusht, 19:56

VIP & Spektakël


Sunny Hill Festival, Dukagjin Lipa jep njoftimin e rëndësishëm: Bileta juaj e Prishtinës, e vlefshme në Tiranë
10 Gusht, 19:54

Kronikë

Aksident në Pogradec, makina përplaset me motorin, plagoset 45-vjeçari dhe djali i tij i mitur
10 Gusht, 19:44

Sociale

Inxhinieria 'mund' mjekësinë! Maturantët zgjedhin arsimin profesional! Rriten aplikuesit në degët bujqësore dhe mësuesi
Enxhi Musaj
10 Gusht, 19:44

Sociale

Ministrja Kushi ndan lajmin e mirë/ Shtohen edhe 150 shkolla në projektin 'Bëjmë Detyrat e Shtëpisë'
10 Gusht, 19:40

Politikë

Meta: Unë i bie më të fortit, e këpus në mes e s'e bëj me porosi! Rama, o bastard
10 Gusht, 19:37

Politikë

Premtimi i Metës: Shtatori do të jetë përvëlues! Siç shemba kioskat e të fortëve të Tiranës, do të shemb edhe këtë regjim që vjedh
10 Gusht, 19:31



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje